



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni pranveror
Kryesia e Kuvendit
P-043

Prishtinë, më 15 korrik 2022, ora 09:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 15 KORRIK 2022

Në mbledhje morën pjesë: Glauk Konjufca, kryetar i Kuvendit; Saranda Bogujevci, Enver Hoxhaj, Kujtim Shala dhe Bekim Arifi, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare në mbledhje morën pjesë: Mimoza Kusari-Lila, Abelard Tahiri, Besnik Tahiri dhe Enis Kervan.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, Ismet Krasniqi, si dhe stafi përgjegjës në mbështetje të Kryesisë së Kuvendit.

Mbledhjen e drejtoi Glauk Konjufca, kryetar i Kuvendit.

Kryesia i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme të Kryesisë së Kuvendit,
2. Pikat e papërfunduara nga seanca e mëparshme,
3. Përgatitjet për seancën e re plenare të radhës,
4. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme të Kryesisë së Kuvendit

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, e mbajtur më 8 korrik 2022.

2. Pikat e papërfunduara nga seanca e mëparshme

Kryesia, pas diskutimeve, vendosi që vazhdimi i seancës plenare me pikat e papërfunduara më 14 korrik 2022 të mbahet të enjten, më 21 korrik 2022, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

3. *Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-150 për ratifikimin e Traktatit mbi ndihmën e ndërsjellë juridike në çështjet penale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Konfederatës Zvicerane,*
4. *Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 08/L-103 për Sistemin e menaxhimit të performansës së komunave dhe skemën e grantit të bazuar në performansë,*
5. *Miratimi i buxhetit të Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me procesin e vendimmarrjes në sektorin e energjisë për periudhën 2006-2022, në nivelin legjislativ, ekzekutiv rregullator dhe në ndërmarrje publike.*

3. Përgatitjet për seancën e re plenare të radhës

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme dhe pas diskutimeve, vendosi që seanca plenare e radhës e Kuvendit të Republikës së Kosovës të mbahet po ashtu të enjten, më 21 korrik 2022, në orën 11:00, me këtë:

Rend dite

1. *Deklarimet jashtë rendit të ditës,*
2. *Pyetjet parlamentare,*
3. *Miratimi i procesverbaleve nga seancat plenare të mëparshme,*
4. *Shqyrtim i dytë i Projektligjit nr. 08/L-065 për produktet biocide,*
5. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-120 për ushqimin,*
6. *Propozimi për zëvendësimin e anëtarit në komision parlamentar,*
7. *Shqyrtimi i Propozim-rezolutës për adresimin e rritjes së çmimeve,*
8. *Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë për Informim dhe Privatësi për vitin 2021,*
9. *Shqyrtimi i raportit vjetor të Ndërmarrjes Publike Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut - KOSTT sh. a. për vitin 2021,*
10. *Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 12/84, datë 22 qershor 2022 për hartimin e Planit Hapësinor të Kosovës,*
11. *Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 13/84, datë 22 qershor 2022, për hartimin e Planit Hapësinor për Parkun Kombëtar “Sharri”,*
12. *Ratifikimi i anëtarit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë Kosovare të Akreditimit,*
13. *Debat parlamentar në lidhje me mosliberalizimin e vizave nga BE-ja për Kosovën.*

Në lidhje me përgatitjet për rendin e ditës të seancës plenare:

- *Kryesia vendosi që për shqyrtimin e Projektligjit nr. 08/L-154 për ratifikimin e “Marrëveshjes së Bashkëfinancimit për studimin e fizibilitetit dhe Projekt-Idesë për lidhjen hekurudhore Durrës-Prishtinë”, në seancë plenare, Komisioni Funkcional për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim ta paraqesë propozimin për plotësimin e rendit të ditës dhe për shmangien nga afatet e parapara me Rregulloren e Kuvendit, pasi raporti për këtë projektligj është paraqitur para afateve të parapara me nenin 56.1 të Rregullores së Kuvendit.*
- *Kryesia, po ashtu, me propozim të kryetares së GP të LVV-së, Mimoza Kusari-Lila, e radhiti në rendin e ditës të lartshënuar, me nr. 7. Shqyrtimi i Propozim-rezolutës për adresimin e rritjes së çmimeve,*
- *Kryesia gjithashtu, me propozim të kryetarit të GP Multietnik, Enis Kervan, e radhiti në rendin e ditës të lartshënuar, me nr. 6. Propozimin për zëvendësimin e anëtarit në komision parlamentar,*
- *Në vazhdim, kryetarja e GP të LVV-së, Mimoza Kusari-Lila, i njoftoi të pranishmit se Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, mund të propozojë në seancë plenare, e caktuar më 21 korrik 2022, plotësimin e rendit të ditës dhe shmangien nga afatet e parapara me Rregulloren e Kuvendit me pikën Shqyrtimi i dytë të Projektligjit për regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave.*

4. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave

1. Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve për drekën e shtruar për delegacionin të deputetëve nga Mbretëria e Bashkuar

Kryesia, në lidhje me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Mbulohen shpenzimet e drekës të shtruar për delegacionin e Parlamentit të Mbretërisë së Bashkuar në shumën prej 335,50 euro, gjatë vizitës së realizuar në Republikën e Kosovës, prej 10 - 15 korrik 2022.

2. Propozimi për rishpalljen e konkursit për dy (2) anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nga komunitetet joshqiptare

Kryetari i njoftoi të pranishmit se edhe në konkursin e shpallur për herë të pestë për dy (2) anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nga komunitetet joshqiptare nuk është plotësuar kushti ligjor për nga numri i kandidatëve.

Diskutimi i plotë i kryetarit është dhënë në transkript.

Në lidhje me çështjen e lartshënuar, diskutuan: nënkryetarja e Kuvendit, Saranda Bogujevci; kryetari i GP Multietnik, Enis Kervan, dhe kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve të lartshënuara, Kryesia mori këtë:

V E N D I M

1. Të rishpallet konkursi publik për zgjedhjen e dy (2) anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nga komunitetet joshqiptare.

2. Ngarkohet Administrata e Kuvendit që, në bazë të dispozitave të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ta publikojë konkursin publik nga pika një (1) e këtij vendimi.

3. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Bernë (Zvicër)

Kryesia, në lidhje me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Arben Gashi, i lejohet udhëtimi zyrtar në Bernë (Zvicër), prej 4 - 7 shtator 2022.

2. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit, të akomodimit dhe mëditjet për të lartshënuarin në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

4. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Athinë (Greqi)

Kryesia, në lidhje me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Saranda Bogujevci dhe Enis Kervan u lejohet udhëtimi zyrtar në Athinë (Greqi), prej 17 - 20 shtator 2022.

2. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit, të akomodimit dhe mëditjet për të lartshënuarit në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

5. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Strasburg (Francë)

Në lidhje me kërkesën e lartshënuar, nënkryetarja e Kuvendit, Saranda Bogujevci, kërkoi që në këtë udhëtim zyrtar të përfshihet edhe kryetari i GP të AAK-së, Besnik Tahiri, si dhe t'u lejohej avanci në shumën prej 1 000 euro, diskutimi i plotë i së cilës është dhënë në transkript.

Pastaj, Kryesia në lidhje me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Saranda Bogujevci, Arben Gashi, Besnik Tahiri dhe Enis Kervan, u lejohej udhëtimi zyrtar në Strasburg (Francë), prej 9 - 15 tetor 2022.

2. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit, të akomodimit dhe mëditjet, si dhe avanci në shumën prej 1 000 euro për të lartshënuarit në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

6. Raportet e kryesuesit të Delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës në Asamblenë Parlamentare të NATO-s në lidhje me pjesëmarrjen në dy aktivitete të kësaj asambleje parlamentare

Kryesia është njoftuar me shkrim nga kryesuesi i Delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës në Asamblenë Parlamentare të NATO-s, Driton Hyseni, në lidhje me pjesëmarrjen e këtij delegacioni në Sesionin Pranveror të kësaj asambleje prej 27 - 30 maj 2022, në Lituani dhe në Komisionin e kësaj Asambleje, prej 6 - 10 qershor 2022, në Bosnjë-Hercegovinë.

Të ndryshme:

- Çështja e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në fund, kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, e shtroi çështjen e punës dhe funksionimit të Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim.

Ai tha se ky komision me 18 anëtarë, në mungesë të kuorumit, nuk po mban mbledhje, as nuk po i shqyrton projektligjet, andaj duhet të shikohet mundësia e rikomponimit të përbërjes së tij.

Diskutimi i plotë i kryetarit është dhënë në transkript.

Kryetari e mbylli mbledhjen në orën 10:20 minuta.

Glauk KONJUFCA

Kryetar i Kuvendit

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale